



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.35, datë 15.05.2018

PËR

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT TELEKOM
ALBANIA SH.A PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.19,
DATË 16.03.2018 TË KËSHILLIT DREJTUES TË AKEP”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 15. 05.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Ankimi administrativ i sipërmarrësit Telekom Albania sh.a për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.19, datë 16.03.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 87 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (***ligji nr. 9918***);

2. Pika 3 e nenit 113, nenet 135, 136, 139 dhe 140 i Ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, ndryshuar me VKD nr.19, datë 16.03.2018 (**Rregullore**);
4. Neni 8 i Rregullores së Brendshme “Për Funksonimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP (**Rregullore e Brendshme**).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Grupi i Punës, si më poshtë:

1. Ankim Administrativ i sipërmarrësit Telekom Albania sh.a, me shkresë me nr. 620/1 prot, datë 16.04.2018 (nr.1134 prot. i AKEP, datë 17.04.2018), me objekt “Ankim Administrativ ndaj Vendimit të AKEP Nr.19, datë 16.03.2018 Për “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren nr43, datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” (*Ankimi administrativ*);
2. Relacionin shpjegues mbi trajtimin e çështjes të paraqitur nga grupi i punës (*Relacioni*);
3. Projekt – akti administrativ miratues (*Vendimi i KD*);

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar;

V Ë R E N :

I. Në aspektin procedural:

1. Akti administrativ Nr.19, datë 16.03.2018 për “Miratimin e dokumentit “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren Nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” është ankimuar nga sipërmarrësi Telekom Albania Sh.a., bazuar në të drejtën dhe procedurën e përcaktuar në pikën 1 të nenit 130 të ligjit nr. 44/2015 dhe dispozitat vijuese të tij;
2. Përmbajtja e Ankimit administrativ është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 131 të ligjit nr. 44/2015 dhe është depozituar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 132 të këtij ligji, pranë organit administrativ të cilit i drejtohet ankimi sipas shkronjës a) të nenit 134/1 të ligjit nr. 44/2015;
3. Ankimi administrativ gjendet në kushtet e pranimit të ankimit sipas nenit 135 të ligjit nr. 44/2015.

II. Në aspektin e trajtimit në thelb të çështjes:

1. Ankimuesi në ankimin administrativ parashtron kërkesën për ndryshimin e :

VKD Nr.19, datë 16.03.2018 për “Miratimin e dokumentit “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren Nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”;

2. Pretendimet dhe kërkesat kryesore të ankimuesit Telekom Albania sh.a për ndryshimin e vendimit të cituar janë si më poshtë:

- Së pari, dokumenti përfundimtar ka ndryshime të rëndësishme nga dokumenti më i fundit i dërguar tek operatorët nga AKEP me datën 9.03.2018. Disa nene të cilat ishin parashikuar në dokumentin më të fundit janë hequr, ndërsa janë shtuar disa nene të tjera të cilat nuk kanë qënë as në dokumentin e parë as në dokumentin e dytë për të cilat operatorët nuk kanë shprehur pozicionin apo komentet e tyre dhe të cilat kanë impakt në operacionet e përditshme;
- Neni 15, pika 6, Telekom Albania kërkon që në këtë pikë gjithashtu të parashikohet që për kërkesa specifike që të ketë operatori duhet që kërkesat për re-patriate të bëhen në çdo moment dhe operatori dhënës të përgjigjet brenda 5 dite pune;
- Neni 18, pika 6, TelekomAlbania kërkon që kjo pikë të jetë “Koha minimale e detyrueshme për kërkesin e bartjes që të qëndrojë në operatorin në të cilin është bartur, përpara se të vendosë një kërkesë tjetër për bartje është 3 muaj. Cdo pajtimtari i lind e drejta e bartjes së numrit tek operatori i zgjedhur prej tij vetëm 3 muaj pasi është bërë pajtimtar i operatorit ekzistues (nëpërmjet bartjes së numrit nga një operator tjetër ose nëpërmjet pajisjes/aktivizimit të shërbimeve me një numër të ri nga operatori ekzistues)”;
- Neni 17, pika 3, kërkon që për raste të veçanta të lihet mundësia e anulimit të procesit të portimit;
- Neni 18, pika 4/iv, vihet re se është shtuar paragrafi “por nuk mund të zgjasë më shumë se 4 orë pune nga marrja e kërkesës”. Ky paragraf nuk ka qënë në asnjë version të dokumentit për këshillim publik dhe nuk është konsultuar me operatorët duke u vendosur apriori nga ana e AKEP dhe kërkon që ky afat të shtyhet në 1(një) ditë pune. Neni 18, pika 5/c, Telekom Albania kërkon që paragrafi “Përveç rasteve të tejkalimit të kapacitetit ditor sipas pikës 10 më poshtë” është hequr duhet te jetë patjetër. Ky paragraf mund të hiqet vetëm nëse kapaciteti ditor është i palimituar. Neni 18, pika 5/c,v, Shënimi 29 “Nëse kontrata me pajtimtarët biznes, përfshin një grup numrash celularë dhe përdorues të ndryshëm të tyre”, detyrimet (dhe kontrata) për përdoruesit që paguajnë individualisht faturat e lëshuara nga operatorët për numrat në përdorim, janë individuale dhe në këto raste këtyre përdoruesve, nuk mund tu mohohet e drejta për portim për shkak të detyrimeve apo përfitimeve të përdoruesve të tjerë të këtij grupi apo pajtimtari Biznes . Nëse numri nuk ka detyrime mujore të papaguara nuk

nënkupton që nuk ka edhe detyrime kontraktuale dhe për këtë arsye TelekomAlbania nuk mund ta pranojë sqarimin nr.29 të rregullores.

Pika 14, kjo pikë është refuzuar edhe në mbledhjen me AKEP nga të gjithë operatorët, pasi pasojë koha prej një ore për korrigjimin/update nuk është e mjaftueshme që nga kërkesa për verifikim deri në veprimet në sistem dhe për këtë arsye Telekom Albania kërkon që të ndryshohet dhe të bëhet “brenda 1(një) dite pune nga korrigjimi/saktësimi i të dhënave”.

- Neni 22, pika 2,3, Telekom Albania kërkon që të përjashtohen nga raportet të gjitha rastet e refuzimeve që vijnë për shkak të performancës së CDRB;
- Neni 23, pika 1, paragrafi i hequr dhe i propozuar nga AKEP “Mos zbatim i portabilitetit sipas nenit 87 të Ligjit 9918 është rasti kur një operator rrjeti publik telefonik nuk ka kryer adaptime të rrjetit për të mundësuar shërbimin e portabilitetit të numrit port out dhe/ose port-in) në rrjetin e tij sipas pikës 5 të nenit 21 të kësaj rregullore, përfshirë detvime të tjera si automatizimi ose nuk kanë masa për rrugezimin në rrjetin e duhur të thirrjeve/mesazheve drejt numrave të portuar”, të jetë pjesë e këtij neni.

III. AKEP pasi e ka gjetur ligjërish të pranueshëm ankimin, lidhur me pretendimet dhe arsyetimin e ankimuesit gjykon si më poshtë vijon:

- a) Në lidhje me ankimin për pikë 6 të nenit 15, dhe propozimin e Telekom Albania që në raste specifike procesi re-patriate të kryhet brenda 5 ditëve nga kërkesa e operatorit dhënës filestar (në vend të cdo 3 muajve të shtuar në ndryshimet e Rregullores), AKEP gjykon se përcaktimet apo shtesat e miratuara nga AKEP më 16.03.2018 (neni 15, pika 6 dhe neni 25/1 , pika 2) janë mëse të mjaftueshme dhe përmirësim i ndjeshëm nga situata e deritanishme kur operatorët celularë nuk kanë kryer aspak procesin repatriate. Shtimi i rasteve specifike do të rriste kompleksitetin dhe subjektivitetin e kërkesave, dhe nuk i shërben përmirësimit të rregullores/procesit. Cdo rast apo kërkesë specifike duhet të detajohet dhe TA nuk ka sjellë argumenta apo asyetim për këtë shtesë të propozuar.
- b) Në lidhje afatin 3 mujor të së drejtës së portimit për aktivizimet e reja (neni 16, pika 7 e Rregullores), AKEP
 - i. Nuk pranon kërkesën e TA, pasi gjykon se janë vet operatorët celularë që kanë krijuar një situatë të tillë (blerjen e një karte SIM te një operatori dhe më pas menjëherë kërkesë për port out tek një operator tjetër). Madje kjo përforcohet në ankimin e TA, e cila përmend si arsye për këtë situatë jo-normale (fraudelente) sjelljen e pikave të shitjes së vet operatorit për të përfituruar më shumë bonuse nga shitja e kartave SIM. Pra operatorët me kërkesën e tyre kërkojnë që të rregullojnë një problem të marrëdhënieve të tyre me kontraktorët/nën-kontraktorët nëpërmjet rregullores së miratuar nga AKEP dhe që synon së pari mbrojtjen e interesave të konsumatorit. AKEP gjykon se operatorët celularë kanë të gjitha mjetet/instrumentat e duhuara në

dispozicion për të rregulluar këtë problem të brendshëm me pikat e shitjes së tyre.

Në pikën 9 të nenit 87 të ligjit nr. 9918 sanksionohet detyrimi për operatorët që afati i aktivizimit të numrit të bartur duhet të jetë brenda një dite pune. AKEP duke iu referuar zbatimit rigoroz të këtij përcaktimi ligjor ka kryer edhe ndryshimet përkatëse në rregullore.

Efektet e ardhura si rezultat i zbatimit të këtij detyrimi ligjor duhet të rregullohen nga operatorët në mënyrë të barabartë duke zbatuar rigorozisht edhe përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9918 lidhur me kontratën e pajtimit për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

- c) Në lidhje me kërkesën e Telekom Albania për nenin 17, pika 3 e Rregullores, për përfshirje të rasteve të vecanta për anulim të kërkesës për portim nga pajtimtari, AKEP gjykon se përcaktimi i dhënë në rregullore është parimor dhe nuk ka ndryshim nga përcaktimet e mëpërshme të rregullores. Argumenti i Telekom Albania se kërkesa për pajtimatë biznes mund të çojë në pagesë “pa dashje” të detyrimeve kontraktore nuk është argument bindës, pasi pajtimatri mund të mos i paguajë ato dhe procesi nuk do të ezkekutohet.
- d) Në lidhje me kërkesën për ndryshimin e afatit 4 orë pune të përcaktuar në nenin 18, pika 4.iv, AKEP duke konsideruar pjesërisht kërkesën, bën riformulimin e kësaj dispozite si më poshtë:
- “6. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të lëvizshme do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar dhe procesuar kërkesat për bartje dhe përgjigjet për to në rolin e Operatorit Dhënës. Për operatorët celularë Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nëpërmjet sistemit të CRDB nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta të 100% të rasteve të muajit kalendarik për pajtimtarët me parapagim. Për përdoruesit celularë me paspagim ky afat nuk do të jetë më i gjatë se **4 orë pune** në 90% të rasteve të muajit kalendarik dhe jo më i gjatë se 1 (një) ditë pune të 100% të rasteve të muajit kalendarik.”*
- e) Në lidhje me kërkesën e Telekom Albania për pikën 5/c të nenit 18, AKEP pranon stimin e paragrafit të cituar nga Telekom Albania “Përvec rasteve të tejkalimit të kapacitetit ditor sipas pikës 10 më poshtë...”, pasi ky paragraf saktëson detyrimet e ODH dhe marrëdhëniet me OM.
- f) Në lidhje me shënimin nr.3 për pikën 5/iv të nenit 18 të Rregullores së ndryshuar, AKEP sqaron se e ka vendosur sqarimin në vijim edhe të shkresave të AKEP në vitet e mëparshme për kontratat në grup dhe kontratat individuale si dhe për të shmangur abuzimet që ndodhin me përdoruesit në kontratat kolektive kur shërbimi celular përdoret dhe paguhet individualisht.
- g) Në lidhje me kërkesën për ndryshim të afatit 1 orë në pikën 14 të nenit 18, AKEP sqaron se ky afat 1 orë pune është për operatorin dhënës që të kryejë veprimet e duhuara për kërkesën për portim brenda 1 ore pune pasi është bërë korigjimi i të dhënave nga ODH apo pagesa e detyrimeve nga pajtimtari.
- h) Në lidhje me kërkesën e Telekom Albania për ndryshim të nenit 22, AKEP sqaron nuk ka nevojë që të vihet sqarimi i kërkuar nga Telekom Albania, pasi

është e qartë se secili operator mban përgjegjësi për veprimet apo mos-veprimet e veta dhe jo për problemet e CRDB.

- i) Në lidhje me kërkesën e Telekom Albania për shtimin e ratseve të mos-automatizimin si shkelje të nenit 87 të ligjit 9918, AKEP sqaron se e ka hequr këtë paragraf që ishte në këshillim publik, pasi përbën tejkalim të përcaktimeve të ligjit 9918.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar në Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 114, neni 115, si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015) neni 130 e në vijim,

V E N D O S:

1. Të pranojë pjesërisht ankimimin administrativ të sipërmarrësit Telekom Albania sh.a, me shkresë me nr. 620/1 prot, datë 16.04.2018 (nr.1134 prot. i AKEP, datë 17.04.2018);
2. Ndryshimin e përcaktimeve të dokumentit Rregullore Nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, e ndryshuar me Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.19, datë 16.03.2018, si më poshtë:
 - a) Pika 5/c të nenit 18, ndryshohet si më poshtë:
 - o “c) në rast të përgjigjes negative, një tregues lidhur me arsyen e refuzimit të kërkesës për bartje, **Përvec rasteve të tejkalimit të kapacitetit ditor sipas pikës 10 më poshtë**, kërkesa mund të refuzohet apo bartja mund të mos-ekekutohet nga ODH vetëm për arsyet e mëposhtëme:...”
 - b) Pika 6 e nenit 18 ndryshohen si më poshtë:

*“6. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të lëvizshme do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar dhe procesuar kërkesat për bartje dhe përgjigjet për to në rolin e Operatorit Dhënës. Për operatorët celularë Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nëpërmjet sistemit të CRDB nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta të 100% të rasteve të muajit kalendarik për pajtimtarët me parapagim. Për përdoruesit celularë me paspagim ky afat nuk do të jetë më i gjatë se **4 orë pune** në 90% të rasteve të muajit kalendarik dhe jo më i gjatë se 1 (një) ditë pune të 100% të rasteve të muajit kalendarik.”*

3. Të njoftohet sipërmarrësi Telekom Albania sh.a. për këtë Vendim;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir ZELA

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Edlira DVORANI**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**